ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**KEK-24-12646-5-2-1**
Nr i brendshëm	**KEKO-24-396-521**

Sa i përket tenderit për: **Trajtimi i materialeve dhe mbetjeve që përmbajnë azbest-faza e parë**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

EGO ELSA SH.P.K&HPC Internacional&SAS Branch in Kosovo&Eko-Studio Projekt

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Llapllasellë, Rruga e Pejes, p.n-Graçanicë

(Adresa)

Graçanicë **10 500**

(Vendi) *(Kodi postar)*

+38349230122 ***N*/A**

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Egon Hoti

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Egoelsa.shpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

22.05.2025

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë me dt. 12.12.2024 Njoftimi mbi vendimin dt. 28.04.2025 Kërkesa për rishqyrtim: 05.05.2025 Vendimi për kërkesën për rishqyrtim: 13.05.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 52 i LPP-së
Neni 56 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik
Neni 43 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me dt.12.12.2024 është publikuar njoftimi për kontratë.

Njoftimi mbi vendimin e AK-së është publikuar me dt.28.04.2025 ku është anuluar aktiviteti i prokurimit me

arsyetimin se nuk ka ofertues të përgjegjshëm, kurse ne kemi pranuar letrën standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin si më poshtë:

Në DT pika 2.4 është kërkuar: Pesë (5) punëtor të certifikuar për punë me asbest sipas standardeve ISO 29993 TRGS 519 për azbest apo ekuivalente, të dëshmohet për akreditim e Institutit I cili lëshon certifikatat ne vendin përkatës.

Ndërsa ju keni prezantuar certifikatat për "Materialet që përmbajnë azbest, lesh mineral dhe transportimi, Pajisjet për monitorim të ajrit dhe rrjedhës së lartë të ajrit", lëshuar nga Instituti Mol, Stara Pazove (Serbi), sipas standardit serb SRPS ISO 29993 i cili nuk pranohet si standard në Republikën e Kosovës dhe certifikatat nuk janë nostifikuar nga organet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, siç parashihet me marrëveshjen për njohjen e diplomave/certifikatave të vitit 2015 në mes Republikës Kosovës dhe Republikës Serbisë.

Sqarim,

Në DT edhe pse nuk është kërkuar qe certifikatat te jene te nostrifikuara. Dokumentet duhet të nostrifikonen duke u bazuar në marrëveshjen për njohjen e diplomave/certifikatave të vitit 2015.

Ju keni dorëzuar certifikatat për aftësim profesional të vozitësve për transport të materieve të rrezikshme për dy punëtorë, por të njëjtit nuk është dëshmuar se janë të aftësuar për paketim të mbetjeve të rrezikshme sipas kërkesës në DT.

Ju keni dorëzuar marrëveshje me Horn & Co. Analytics Gmbh, por laboratori i akredituar sipas standardeve ISO 17025, nuk përmban metodën SEM/EDX/(Scanning Electron Microscopy-VED 3492, BIA7478) siç është kërkuar në DT.

Në DT aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME. Pika 6.2.Transportimi, është kërkuar që Mbeturinat e azbestit duhen të transportohen në kamionë të mbyllur. Ndërsa ju keni ofruar kamion kiper 2 dyer (i hapur).

Në DT është kërkuar Peshëngritëse – pirunerë, ndërsa ju keni ofruar pajisje LUGË NGARKUESE.

Ju nuk keni ofruar dokumentet që dëshmohet për dhomën e dekomisionimit, dokumentet e ofruara janë për Tualete.

Fillimisht sqarojmë se në këtë tender kemi vlerësim jo profesional dhe subjektiv të AK-së, ndërsa si dëshmi që kemi vlerësim të njëanshëm dhe subjektiv e dëshmon fakti se njëri anëtar i komisionit të vlerësimit, e që është zyrtar i prokurimit e ka konsideruar ofertën tonë si të përgjegjshme.
Autoriteti kontraktues ka vepruar në mënyrë arbitrare në këtë tender duke na diskriminuar neve si kompani e përgjegjshme dhe me përvojë të dëshmuar në këtë fushë. Realisht kompani jonë është e njohur për autoritetin kontraktues në aspektin profesional dhe në përmbushje të kontratave.

- Sa i përket punëtorëve të certifikuar, sqarojmë se ne kemi ofruar dëshmitë/certifikata për pesë punëtorët mirëpo këto certifikata nuk janë vlerësuar fare nga e Autoritetit Kontraktues prandaj ky veprim përbën diskriminim për kompaninë tonë.

Në dosje të tenderit është kërkuar:
2.4 Pesë (5) punëtor të çertifikuar për punë me asbest sipas standardeve ISO 29993 TRGS 519 per azbest apo ekuivalente .
2.4 Të dëshmohet me çertifikatat për punë me azbest sipas normave ISO 29993 TRGS 519 AZBEST apo ekuivalente. Te deshmohet per akreditim e Institutit I cili leshon çertifikatat ne vendin perkates.

Në lidhje me këtë kërkesë ne kemi ofruar dëshmitë përkatësisht certifikatat për punë me asbest sipas TRGS 519 për pesë punëtorë dhe dëshminë e akreditimit të institutit që i ka lëshuar certifikatat.

Në lidhje me këtë pikë sqarojmë se ne kemi ofruar dy lloj certifikata me dy standarde të kërkuara për

këta punëtorë, konkretisht standardet ISO 29993 TRGS 519. Kemi ofruar certifikatat nga instituti Mol e poashtu edhe certifikatat nga instituti Umwelt offenbach nga Gjermania.
Certifikatat nga Gjermania nuk janë vlerësuar fare.
Të certifikuar me dy standarde janë 6 punëtorët si në vijim:
Avni Hoti, Egon Hoti, Fledi Hoti, Endrit Murati, Arton Sejduiu dhe Ferid Shabani. Ju lutem analizojeni dokumentet e ngarkuara me dosje të tenderit, pasi që AK-së nuk i ka analizuar fare.
Sa i përket nostrifikimeve të përmendura në letrën standarde për tenderues të eliminuar, sqarojmë se askund në dosje të tenderit nuk është kërkuar që të nostrifikohen certifikatat, prandaj me këtë rast AK-së ka vepruar në kundërshtim me nenin 56.3 të LPPP-ë, pasi që aty ceket shumë qartë që "3. *Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*.

- Sa i përket arsyes kinse ne nuk kemi ofruar certifikata për dy vozitësit se janë të aftësuar për paketim

të mbetjeve të rrezikshme sipas kërkesës së dosjes së tenderit, sqarojmë se kjo arsye e eliminimit është plotësisht e pa abuzuar dhe e paqëndrueshme sepse ne kemi ofruar certifikata siç janë kërkuar në dosje të tenderit

2.5 Dy(2) punetor te trajnuar per paketimin dhe transportin e mbetjeve te rrezikshme me ADR
2.5. Te deshmohet me çertifikata mbi trajnimin me ADR qe nenkupton qe jan te trajnuar ne paketimin dhe transport te mbetjeve te rrezishme . OE duhet te dorëzoj çertifikata apo licenca për azbest te lëshuara nga Instituti qe eshte i çertifikuar per Trajnimin e Experteve . OE duhet te deshmoj per akreditim e Institutit ne vendin perkates I cili leshon çertifikatat

Në lidhje me këtë kërkesë kemi ofruar dëshmi për punëtorët z.Hekuran Ademi dhe Leutrim Zeqiri, ku janë të prezantuar certifikatat e lëshuara nga Instituti Mjedisor OFFENBACH GMBH, i cili është i akredituar dhe që dëshmohet se këta dy punëtorë janë të certifikuar për punë me azbest, e ku si dëshmi është bashkangjitur edhe dëshmia e akreditimit. Po ashtu këta punëtorë janë të certifikuar për paketimin dhe transportin e mbetjeve të rrezikshme me ADR. Nga këto dëshmi kuptohet qartë se ne jemi diskriminuar dhe nuk jemi trajtuar barabartë në harmoni me nenin 7 të LPP-së.

- Në lidhje me arsyen e eliminimit se ne kemi ofruar marrëveshjen me Horn&Co Analytics GMBH

por laboratori i akredituar sipas standardeve Iso 17025 nuk përmban metodën Sem/Edx siç është kërkuar, sqarojmë se kjo arsye e eliminimit është e pa bazuar.
Në dosje të tenderit është kërkuar si më poshtë:
3.1Operatori Ekonomik duhet të ketë te kete marrveshje bashkpunimi me laborator të akredituar sipas standardeve ISO 17025, dhe metodes SEM EDX (Scanning Electron Microscopy-VED 3492,VDI3866,BIA7478)
3.1. Te deshmohet me marreveshje bashkepunimi origjinale ose te noterizuar.

Autoriteti kontraktues nuk e ka analizuar fare marrëveshjen në fjalë, prandaj kërkojmë nga ju që të analizoni marrëveshjen, akreditimin dhe aneks akreditimin ku figuron shumë qartë që Laboratori është i akredituar me ISO 17025 e po ashtu përmban edhe metodën SEM/EDEX, ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit. Kjo arsye e eliminimit nuk mund të quhet ndryshe përveç se veprim diskriminues dhe tendencioz i AK-së ndaj kompanisë tonë. Duke qenë të gjitha dëshmitë e bashkangjitura me ofertë e të thuhet që nuk janë këto dëshmi është më të vërtetë një absurditet i llojit të vetë.
Tek marrëveshja në fjalë, standardi i kërkuar gjendet në faqe 67 pika 14.
Këto fakte janë evidentuar edhe në raportin e vlerësimit, ku njëri anëtarë i komisionit e ka cilësuar ofertën tonë të përgjegjshme.

- Në lidhje me arsyen e eliminimit se ne kemi ofruar kamionë kiper 2 dyer (i hapur), ndërsa në dosje të tenderit është kërkuar që mbeturinat e azbestit duhet të transportohen me kamionetë të mbyllur, sqarojmë se kjo arsye e eliminimit është e pabazuar dhe e paqëndrueshme sepse në dosje të tenderit nuk është përcaktuar

se çfarë kamioni duhet të jetë, i hapur apo i mbyllur, prandaj jemi eliminuar për një kërkesë që nuk ka qenë e përcaktuar në dosje të tenderit.
Ne me dosje të tenderit kemi ofruar dëshmi për një kamion, mirëpo ne kemi edhe kamion të mbyllur, e të cilat dëshmi i kemi bashkëngjit me kërkesë për rishqyrtim e po ua bashkangjesim edhe me ankesë, edhe pse nëse ka pasur AK-së ndonjë dilemë në lidhje me këtë dëshmi është dashur të kërkojë sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.
Ne realisht kemi edhe kamion të mbyllur e kjo mund të vërtetohet lehtë nga libreza dhe fotot të cilat po i bashkëngjesim tani.

Shih Foton dhe librezën:

5m
ZEPRO
ZEPRO
01 295-FZ



A	Numri i regjistrimit; Број регистрације; Registration number;	01-295-FZ
I	Data e regjistrimit; Датум регистрације; Registration date;	24.07.2024
C	Të dhënat personale; Лични подаци; Personal data;	
C.2	Pronari i mjetit; Власник возила; Owner of the vehicle;	
C.2.1	Mbiemri ose emri i biznesit; Презиме или пословно име; Surname or business name;	EGO ELSA SH.P.K.
C.2.2	Emri; Име; Name;	
C.2.3	Adresa; Адреса; Address;	Rruga e Pejës, p.n Graçanicë
B	Data e regjistrimit të parë; Датум прве регистрације; Date of first registration;	29.03.2016
D	Automjeti; Возило; Vehicles;	
D.1	Prodhuesi; Произвођач; Make;	Peugeot
D.2	Tipi; Тип; Type;	Y
D3	Përshkrimi komercial; Комерцијални опис; Commercial description(s);	BOXER
E	Numri identifikues i automjetit; Идентификациони број возила; Vehicle identification number;	VF3YDTMAU12783475
S	Viti i prodhimit; Година производње; Year of production;	2016
S	Kapaciteti i vendeve; Капацитет места за седење; Seating capacity;	3
S.1	Numri i vendeve; Број места за седење; Number of seats;	
S.2	Numri i vendeve për qëndrim; Број места за стојање; Number of standing places;	
Q	Raporti Fuqi/ Peshë (në kW/kg); Однос Снага/Маса (у kВ/кг); Power / Weight ratio (in kW/kg);	
F	Pesha; Маса; Mass;	
F1	Pesha maksimale e ngarkesës së lejuar; Највећа дозвољена маса; Maximum permissible laden mass;	3500
G	Pesha e automjetit; Маса возила; Mass of the vehicle;	1015 / 2485
K	Homologimi; Хомологирање; Type of approval;	
P	Motorri; Motor; Engine;	
P1	Kapaciteti (në cm3); Запремина (у цм3); Capacity (in cm3);	2198
P2	Fuqia maksimale neto (në kW); Максимално нето снага (у кВ); Maximum net power (in kW);	96.00
P3	Lloji i karburantit ose burimi i energjisë; Врста горива или напајања; Type of fuel or power source;	Dizel
R	Ngjyra e automjetit; Боја возила; Color of the vehicle;	0 - E BARDHË
2A	Ndërtimi; Конструкција; Construction;	Kamionetë me 2 dyer
	Shënime; Напомене; Remarks;	EGO ELSA

- Sa i përket pirunerit të cilin e ka cekur AK-së kinse ne nuk e kemi ofruar, sqarojmë se

edhe kjo arsye e eliminimit është plotësisht e pa bazuar sepse ne kemi ofruar dëshmi për piruner dhe ky fakt vërtetohet nga dëshmitë e bashkangjitura ne dosje të tenderit. Edhe tek piruneri nuk është kërkuar ndonjë kërkesë specifike, as peshë, as madhësi etj, prandaj piruneri i ofruar nga ne është sipas kërkesës së dosjes së tenderit, pra është piruner e jo lugë ngarkuese siç e ka cilësuar AK-së, e cila mund të shihet qartë tek fotot e makinerisë.

Nëse eventualisht ka pasur ndonjë paqartësi apo dilemë, kanë mundur të kërkohen sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së. Ndërsa sa për korrektësi, ju sqarojmë se ne kemi edhe piruner më të vogël, e për të cilin po ua bashkangjesim dëshmi fotot, faturen dhe konfirmimin e pagesës.

FIAMM
F|I|A|T
F|I|A|T

Sa për dijeninë tuaj, ne po ua bashkëngjisim edhe faturën me konfirmim të pagesës për pirunerin, prandaj nga këto dëshmi vërtetohet saktë se kërkesa për piruner përmbushet plotësisht, ndërsa autoriteti kontraktues ka mundur shumë lehtë të zbatojë nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së që të vërtetojë këtë fakt.

Po ashtu këto dokumente që po ua bashkëngjisim vërtetohen në mënyrë objektive sipas nenit 72.3 të LPP-së pasi që data e këtyre dokumenteve (faturës dhe transaksionit) është para datës së hapjes së ofertave.
Shih më poshtë faturën dhe transaksionin Bankar:

BADALLAJ 5 SH.P.K.

Emri i biznesit: BADALLAJ 5 SH.P.K.

Nr. Unik Identifikues: 810603888 Adresa: Vlashnje
Nr. TVSH-së: 330069387 Vendi: Prizren

E-mail: badallaj.5@hotmail.com
Tel.: +383 44 146 112

Faturë / Invoice

Klienti: **EGO ELSA SH.P.K. [EGO ELSA]**

Nr. Unik Identifikues: 811469833 Nr. TVSH-së: 0
Adresa: Llapllasellë, Rruga e Pejes, p.n
Vendi: Graçanicë
Tel.: +3834/9230122

Data	Nr. Faturës	Për Pagesë
22.02.2024	FSM-24-000005	1,750.00

Data e skadimit:	Nr. i porosisë	Data e Porosisë	Referenca:	Referenti juaj:	Agjenti tregtar:
22.02.2024	-	-		Administratori	

Nr.	Emërtimi i Artikullit	Njës. mat.	Sasia	Çmimi pa TVSH	Çmimi me TVSH	Vlera	Zbritje (%)	Çmimi me Zbritje	TVSH (%)	TVSH	Totali
1	Pirunet elektrik Fiat Pesha 1250 kg	KG	1250	1.19	1.40	1,483.05	0.00 %	1.40	18 %	266.95	1,750.00

Norma Tatimore	Vlera pa TVSH	TVSH	Vlera me TVSH
TVSH - 0 %	0.00	0.00	0.00
TVSH - 8 %	0.00	0.00	0.00
TVSH - 18 %	1,483.05	266.95	1,750.00

Vlera pa Zbritje:	1,483.05 EUR
Zbritje:	0.00 EUR
Vlera pa TVSH:	1,483.05 EUR
TVSH:	266.95 EUR
Totali i Faturës:	**1,750.00 EUR**
Pagesa e tanishme:	1,750.00 EUR
Pagesa tjera:	0.00 EUR
Detyrimi i mbetur:	0.00 EUR

Totali i Faturës me fjalë:
Një Mijë Shtatë Qind Pesëdhjet
Pagesa e Faturës duhet të bëhet brenda 15 ditëve.

Faturoi: Administratori

Dërgoi

Pranoi: EGO ELSA SH.P.K. [EGO ELSA]

BADALLAJ 5 SH.P.K PRIZREN

Llogaritë Bankare: **Raiffeisen Bank : 1502001000279596** **IBAN : XK05 1502 0010 0027 9596** **SWIFT CODE : RBKOXKPR**
Banka Korrespodente : RZBAATWW

www.trefin-ks.com

Faqe 1 / 1

PriBank

PriBank
Rr. "Sicilia" Kompleksi Lubjana/Kalabri,
Blloku A1/2, Nr. 2, 10000, Prishtinë
+38338747777
info@pribank-ks.com
www.pribank-ks.com

Transaction Overview	**Status: Approved**
Transaction date	26.02.2024 08:17:16
Transaction ID	11600022514005
Ordering party	EGO ELSA
Ordering party account	2410130100069194EUR
Ordering party address	RRUGA E PEJES PN LLAPLLASELLE GRACANICE
Beneficiary	badallaj 5 shpk
Beneficiary account	1502001000279596
Beneficiary address	N/A
Transaction details	Pagese e fat nr fsm-24-000005
Info	
Purpose code	Pagesat Nd rbankare - E rregullt
Amount	1.750,00 EUR

04.05.2025 10:36:22 PM

PriBank e-banking

- Sa i përket arsyes tjetër të cekur në letrën standarde për tenderues të eliminuar, sqarojmë se edhe kjo arsye është e pa bazuar, pasi që ne kemi ofruar dëshmi për dhomën e dekomisionimit edhe pse në FDT nuk ka pas ndonjë kërkesë të veçantë për të ofruar ndonjë dëshmi konkrete, prandaj nuk mund ët eliminohemi për një kërkesë e cila nuk ka qenë përcaktuar në dosje të tenderit, sepse kjo bie në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues nuk ka shpreh gatishmëri për të vlerësuar drejtë ofertën tonë, pasi që nuk ka shfrytëzuar nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së për të kërkuar sqarime eventuale në lidhje me ndonjë dilemë përkitazi me dëshmitë e ofruara nga ne.

- Grupi i OE "**ASSET ING&AZ BUILDING DEVELOPMENT L.L.C**" është i papërgjegjshëm ashtu siç e ka cilësuar autoriteti kontraktues, prandaj arsyet e dhëna nga AK-së janë edhe pretendime tona ankimore.
  Ky grup i OE është eliminuara me arsyetimin si më poshtë:

Në DT Është kërkuar që OE duhet te dorëzoj certifikata apo licenca për azbest te lëshuara nga Instituti qe është i certifikuar për Trajnimin e Ekspertëve, ndërsa ju keni ofruar vetëm Deklaratë me përshkrim: Me poshtë keni te bashkangjitur lingut e akreditimit te institutit e cila ka lëshuar certifikatën për Heqjen e Azbestin me Code : 31696-7035-8070, e lëshuar nga COMPLIANCE CENTRAL.
https://www.cpdqs.co.uk/provider/compliance-central

Ju keni dorëzuar një marrëveshje të notorizuar me SGS Albania, por laboratori i akredituar në Shqipëri sipas standardeve ISO 17025, nuk përmban metodën SEM/EDX/(Scanning Electron Microscopy-VED 3492, BIA7478). OE ka bashkangjitur edhe akreditimin dhe një aneks të deklarimit të akreditimit të SGS Search Laboratorium B.V Hesswijk Dinther Holande por nuk ka bashkangjitur marrëveshje me këtë laborator.

Në DT është kërkuar pajisje për monitorimin e fibrave te azbestit ne ajër. Aparatura-kampionatori duhet te jetë pajisje me autonomi pune dhe te ketë te paktën 16 filtra për kamponim 16 ditor te pavarur dhe me printer te integruar për printimin e rezultateve te kampionimit, ndërsa ju keni ofruar pajisje me 1 filtër për kamponim, gjithashtu i mungon printeri i integruar për printimin e rezultateve të kampionimit.

Në DT aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME. Pika 6.2.Transportimi, është kërkuar që Mbeturinat e azbestit duhen të transportohen në kamionë të mbyllur. Ndërsa ju keni ofruar 3 kamion. 2 kamion kiper 2 dyer (i hapur) dhe një kamion për transport të materieve të rrezikshme pa dokumentacion.

Në DT pika në tabelat 10.1, 10.2 është kërkuar:
Krijimi i njësive të dekontaminimit:
Vendosja e dhomës së dekontaminimit me sistemin e mbylljes , e pajisur me tri dhoma, zhveshje-veshje-dalje. Zhveshje-pastrimi me ujë-veshja dhe me sistemin e pastrimit te ujit me filtër që parandalon fibrat të kalojnë përmes ujerave te zeza. Sistemet e mbylljes së dezinfektimit duhet të instalohen për t'i lejuar punëtorët të heqin veshjet, këpucët dhe mjetet e kontaminuara.

Ju keni ofruar dhomën e dekontaminimit vetëm me një dhomë montazh e mbuluar me plastmasë. I mungojnë dy dhoma, sistemi për pastrim të ujit me filtër, sistemi i mbylljes.

Ju mungon certifikata ISO 17025.

Ka mos përputhje te çmimit nga formulari i tenderit dhe përshkrimi i çmimeve, meqrast sipas rregullores per prokurim publik neni 40.10 pika b: Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet.

Ne me dt.13.05.2025 kemi pranuar vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, ku AK-ja e ka cekur si në vijim:

Pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, komisioni e ka shqyrtuar atë dhe vlerëson se pretendimet e OE ankuesit nuk qëndrojnë.

Komisioni teknik i vleresimit konsideron se pretendimet e OE ankues jane te pa bazuara per arsyet e meposhtme:

Në DT pika 2.4 është kërkuar: Pesë (5) punëtor të çertifikuar për punë me asbest sipas standardeve ISO 29993 TRGS 519 per azbest apo ekuivalente, të deshmohet per akreditim e Institutit I cili leshon çertifikatat ne vendin perkates.
Ndërsa GOE Certifikatat e prezantuara për "Materialet që përmbajnë azbest, lesh mineral dhe transportimi, Pajisjet për monitorim të ajrit dhe rrjedhës së lartë të ajrit", lëshuar nga Instituti Mol, Stara Pazove (Serbi), sipas standardit serb SRPS ISO 29993 i cili nuk pranohet si standard në Republikën e Kosovës dhe certifikatat nuk janë notifikuar nga organet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, siç parashihet me marrëveshjen për njohjen e diplomave/certifikatave të vitit 2015 në mes Republikës Kosovës dhe Republikës Serbisë.
Sqarim,
Në DT edhe pse nuk është kërkuar qe certifikatat te jene te nostrifikuara. Dokumentet duhet të nostrifikonen duke u bazuar në marrëveshjen për njohjen e diplomave/certifikatave të vitit 2015.

GOE ka dorëzuar certifikatat për aftësim profesional të vozitësve për transport të materieve të rrezikshme për dy punëtorë, por të njëjtit nuk është dëshmuar se janë të aftësuar për paketim të mbetjeve të rrezikshme sipas kërkesës në DT.

OE Ego Elsa sh.p.k. ka dorëzuar marrëveshje me Horn & Co. Analytics Gmbh, por laboratori i akredituar sipas standardeve ISO 17025, nuk përmban metodën SEM/EDX/(Scanning Electron Microscopy-VED 3492, BIA7478) siç është kërkuar në DT.

Në DT aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME. Pika 6.2.Transportimi, është kërkuar që Mbeturinat e azbestit duhen të transportohen në kamionë të mbyllur. Ndërsa GOE kan ofruar kamion kiper 2 dyer (i hapur).
Sqarim,
GOE nuk ka ofruar në ofertë Kamionetën siç ceket në ankesë për ri shqyrtim dhe nuk merret parasysh.

Në DT është kërkuar Peshëngritëse – pirunerë, ndërsa GOE ka ofruar pajisje LUGË NGARKUESE.
Sqarim,
GOE nuk ka ofruar në ofertë piruner siç është kërkuar në DT. Pirunari i ofruar në ankesë për ri shqyrtim nuk merret parasysh.

GOE nuk ka ofruar dokumentet që dëshmohet për dhomën e dekomisionimit, dokumentet e ofruara në ofertë nga GOE janë për Tualete.

Ky arsyetim i AK-së është plotësisht i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar, pasi që vetëm janë përsëritur arsyet e eliminimit në letrën standarde për tenderues të eliminuar dhe nuk është thënë asgjë më tepër.
Sa i përket certifikatave të lëshuara nga Instituti Mol, ku AK-së e ka cekur se këto certifikata nuk pranohen si standard në Republikën e Kosovës, sqarojmë se asnjë pengesë dhe asnjë ndalesë nuk është në fuqi në Kosovë për këto certifikata, prandaj ky arsyetim është jo profesional dhe i paqëndrueshëm. Përkundrazi Instituti Mol nga starapazova ka kryer disa aktivitete në vazhdimësi tek KEK, e po ashtu edhe në identifikim të analizave të asbestit dhe lëshimit të raporteve free asbest të cilat ju i keni të dokumentuara.
Pavarësisht këtyre dëshmive, ne me dosje të tenderit kemi bashkangjit edhe certifikatat nga instituti Umwelt offenbach nga Gjermania, e të cilat Certifikata nuk janë vlerësuar fare nga AK-së e po ashtu edhe në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim, autoriteti nuk është lëshuar fare tek këto certifikata.

Sa i përket pretendimit të AK-së se edhe pse nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit që certifikatat të

nostrifikohen ato duhet të nostrifikohen, sqarojmë se vlerësimi i ofertave çdo herë bëhet duke marr për bazë kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, prandaj në këtë rast po veprohet në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së.
Sa i përket pretendimit të AK-së, se dy punëtorët nuk janë të aftësuar për paketim të mbetjeve të rrezikshme sipas kërkesës së dosjes së tenderit, e kemi sqaruar edhe më lartë se kemi ofruar dëshmi për punëtorët z.Hekuran Ademi dhe Leutrim Zeqiri, ku janë të prezantuar certifikatat e lëshuara nga Instituti Mjedisor OFFENBACH GMBH, i cili është i akredituar, e ku si dëshmi është bashkangjitur edhe dëshmia e akreditimit, prandaj autoriteti kontraktues vetëm i ka përsëritur arsyet e eliminimit pa dashur ti analizojë dëshmitë konkrete të ofruara nga ne.

AK-së kontraktues po ashtu vetëm e ka përsëritur arsyen e eliminimit për marrëveshjen e ofruar nga ne me Horn&Co Analytics GMBH dhe nuk ka marr parasysh dëshminë marrëveshjen, akreditimin dhe aneks akreditimin ku figuron shumë qartë që Laboratori është i akredituar me ISO 17025 e po ashtu përmban edhe metodën SEM/EDEX, ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit

Sa i përket kamionit të ofruar nga ne, AK-së tani gjatë rishqyrtimit të kërkesës tonë për rishqyrtim merret vetëm me dëshminë për kamioneten dhe dëshmitë që i kemi ofruar me kërkesë për rishqyrtim, ndërsa nuk merret fare me dëshmitë të cilat i kemi bashkangjit me dosje për kamionin të cilin e kemi ofruar sipas kërkesës së dosjes së tenderit, pasi që në dosje të tenderit nuk ka qenë e cekur se kamioni a duhet të jetë i mbyllur apo i hapur. Ne e kemi bërë të qartë se ligjërisht nuk mund të eliminohemi për një kërkesë që nuk ka qenë në dosje të tenderit sepse këtë e ndalon neni 56.3 i LPP-së.

Sa i përket pirunerit, edhe për këtë pretendim autoriteti kontraktues është përgjigjur vetëm për dëshminë shtesë të ofruar me kërkesë për rishqyrtim për një tjetër pirunier që ne e posedojmë, ndërsa nuk merret fare me pirunerin për të cilin i kemi bashkëngjit dëshmitë me dosje të tenderit dhe në këtë mënyrë kemi shmangie të dhënies së përgjigjeve konkrete nga ana e AK-së.

Dëshmitë për pirunerin i kemi bashangjit me dosje të tenderit, e jo siç pretendon AK-së lugë ngarkuese, e po ashtu me kërkesë për rishqyrtim kemi bashkëngjitë edhe dëshmi të tjera për një piruner tjetër vetëm për të argumentuar se i kemi dy piruner, pavarësisht që është kërkuar një i tillë. Edhe për piruner nuk ka ekzistuar ndonjë kërkesë specifike, prandaj ne e përmbushim këtë kërkesë.

Autoriteti kontraktues është përgjigjur në mënyrë të njëjtë edhe sa i përket dhomës së dekomisionimit, ku vetëm e ka cekur se dëshmitë e ofruara janë për toalete. Edhe kjo përgjigje dëshmon për njëanshmëri të plotë të AK-së dhe mos interesim fare për dëshmitë e ofruara nga ne e po ashtu dëshmon se K-së nuk merr parasysh kërkesat e dosjes së tenderit edhe pse vetë i ka formuluar ato. Nuk ka ekzistuar asnjë kërkesë specifike për dhomën e dekomisionimit, prandaj edhe nuk mund të eliminohemi për ndonjë kërkesë që nuk është specifikuar në dosje të tenderit.

Nga dëshmitë që u cekën më lartë dhe arsyetimet tona, kuptohet qartë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Ky tender është anuluar në kundërshtim të plotë me nenin 62 të LPP-së dhe me nenin 43.5 dhe 43.7 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik, sepse asnjëra prej kushteve të përcaktuar në këto dispozita nuk janë plotësuar.

Pra ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe ashtë dashur të konsiderohet oferta jonë si e tillë dhe të shpallemi fitues të kësaj kontrate.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e

parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente", mirëpo AK-së nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore, sepse na ka eliminuar pa asnjë bazë ligjore dhe pa asnjë dëshmi konkrete.

Duke u bazuar në të gjitha ato dëshmi të prezantuar, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.*

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të shqyrtoj ankesën tonë dhe të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE "EGO ELSA" SH.P.K.
ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (formulari B58) për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën para ofertuese.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*